



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2555/2 Prot.

Vlorë më, 20.10. 2025

VENDIM

Nr. 42, datë 20/10.2025

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË PAGËS PËR PËRGJEGJËSIN E SEKTORIT TË
AUDIT TI BRENDSHËM TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 49 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, ", VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.16, datë 16.06.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e VKM nr.325, datë 31.05.2023", referuar propozimit të Sektorit të Auditit të Brendshëm ardhur me shkresë 2495 Prot, datë 14.10.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.10.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kategorinë e pagës për pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Auditit të Brendshëm, sipas kategorisë III-2.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Sektori Ekonomik, dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës -Akademike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI AUDITIT TË BRENDSHËM**

Nr. Prot.

2495

Vlorë, më 14 / 10 / 2025

Lënda: Për zbatimin e Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

Në zbatim të Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", dhe konkretisht sipas lidhjes nr. 3, pika 24, e cila përcakton:

"Në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, në masën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për pozicionin 'drejtor drejtorie', nëse funksioni i auditimit të brendshëm të institucionit është i organizuar në nivel drejtorie, dhe për nëpunësin në pozicion 'përgjegjës sektori', nëse ky funksion është i organizuar në nivel sektori,"

duke qenë se në strukturën organizative të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë funksioni i Auditimit të Brendshëm është i organizuar në nivel sektori, kërkoj zbatimin e shtesës prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, të parashikuar nga vendimi i mësipërm, për pozicionin "Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm".

Kjo kërkesë mbështetet gjithashtu në përgjigjen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila konfirmon mënyrën e zbatimit të vendimit në përputhje me strukturën aktuale të miratuar dhe fondet e përcaktuara, si dhe në certifikimin profesional ndërkombëtar të fituar nga CEF – Center of Excellence in Finance dhe CIPFA – The chartered institute of public finance and accountancy, për diplomimin si Auditues i Brendshëm Ndërkombëtar, që përbën një vlerë të shtuar profesionale dhe institucionale për universitetin.

Në këtë kuadër, kërkoj që Bordi i Administrimit të shqyrtojë dhe të miratojë zbatimin e kësaj shtese në pagën mujore të pozicionit "Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm",



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI AUDITIT TË BRENDSHËM

në përputhje me përmbajtjen e lidhjes nr. 3 të Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, duke llogaritur efektet përkatëse që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit.

Përgjegjes Sektori

Marjanthi Rrapaj